

Drejtuar:
Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Juridik,
Universiteti i Tetovës

R E F E R A T

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës në sfera Komunikime dhe Mas-Medime (50706 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Në bazë të Konkursit për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës të datës 17.03.2023 të shpallur në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, www.unite.edu.mk dhe në gazetata ditore « Koha » dhe « Слободен Печат » për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në sferën Komunikime dhe Mas-Medime (50706 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, me Vendim të Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Juridik nr. 13-220/4 të datës 06.04.2023 formohet Komisioni recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Briseida MEMA - Kryetare**
- 2. Prof. Dr. Makdolna (Dona) KOLAR - PANOV - Anëtare**
- 3. Prof. Dr. Ferat POLISI - Anëtar**

Ky komision recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur, dhe në përputhje me nenet 172, 173, 175 dhe 176 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 82/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 178/2021), me Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Senatit të Universitetit të Tetovës këtë:

R E C E N S I O N

Në konkursin e datës 17.03.2023, shpallur në web faqen e Universitetit të Tetovës www.unite.edu.mk dhe në gazetata “Koha” dhe “Слободен Печат”, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët nga sfera e Komunikimeve dhe Mas-Medias (50706 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, ka konkurruar një kandidat i vetëm: Prof. Dr. Aurora Karameti.

- 1. Prof. Dr. Aurora Karameti: të dhënat biografike**

Sipas dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja **Prof. Dr. Aurora (Ndrio) Karameti** ka lindur më 04.11.1974 në Lushnjë, Republika e Shqipërisë. Studimet universitare i ka kryer në

periudhën 01.09.1996-15.07.2000 në *Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës* në degën “Gazetari” dhe është diplomuar “Gazetar” (program 4-vjeçar). Studimet e Masterit i ka kryer në periudhën 01.10.2003-15.07.2005 në *Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës* me mbrojtjen e tezës: “Pasqyrimi në media i konfliktit në Maqedoni: Janar-Gusht 2001”. Studimet doktorale i ka kryer në periudhën

01.10.2005-28.03.2011 dhe i përfundoi me marrjen e titullit “Doktor i shkencave të informacionit dhe komunikimit” nga *Universiteti Sorbonne Nouvelle Paris 3* në Francë ku mbrojtji publikisht tezën “Shtypi shqiptar dhe ndërkombëtar dhe mbulimi i aktualitetit në Maqedoni : Analizë e një korpusi shumë-gjuhësor nga janari në gusht 2001”, me vlerësimin e lartë “*Très honorable*” (Shumë e nderuar).

Kandidatja Prof. Dr. Aurora Karameti dorëzoi këto dokumente në konkurs:

Diplomën e Doktoratës (kopje) DHE Vërtetimin e Nostrifikimit të saj (kopje) si edhe fotokopje të tezës (376 faqe), Diplomën Master (kopje) DHE Vërtetimin e Nostrifikimit (kopje), Diplomën e Fakultetit (kopje) DHE Vërtetimin e Nostrifikimit të saj (kopje), Vendimin për zgjedhje-rizgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore Profesor Inordinar/Asociuar (kopje), listën e punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara në revista shkencore DHE kopje të punimeve të publikuara, një ekzemplar të librit të botuar dhe kopje të kapitullit nga libri kolektiv i botuar, kopje të certifikatave nga konferencat shkencore, biografi të shkurtër, vërtetim për njohje të një gjuhe të huaj (kopje), certifikatë vetjake nga libri amzë, certifikatë shtetësie.

2. PERVOJA UNIVERSITARE

Karrierën universitare kandidatja Prof. Inord. Dr. Aurora Karameti e ka nisur prej 01.12.2003 si mësimdhënëse në Fakultetin e Shkencave dhe Teknologjive të Komunikimit, në Departamentin e Komunikimit, të Universitetit të Europës Jug-Lindore në Tetovë (UEJL), ku ka marrë thirrjen mësimore-shkencore *Asistent* dhe ku ka punuar deri më 20.09.2011. Prej 20.03.2005 deri më 30.09.2005 kandidatja ka punuar në Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare po të UEJL, si zyrtare e ngarkuar me Shkëmbimet Akademike dhe Studentore.

Nga 01.02.2012 kandidatja u angazhua si mësimdhënëse me kohë të pjesshme në Programin Studimor të Gazetarisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Me Vendim te Rektoratit te Universitetit Shtetëror të Tetovës Nr. 046207/1 të datës 27.12.2012 kandidatja mori thirrjen *Docent* për lëndët : 1. « Teoritë e modernizmit dhe media globale » dhe « Redaktimi në media », në Programin Studimor të Gazetarisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Këto lëndë i ligjëron edhe aktualisht bashkë me lëndët “Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor” dhe “Psikologjia e komunikimit”. Kandidatja është e angazhuar në mësimdhënie edhe në Programin Studimor të Kriminalistikës ku mban lëndën « Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun ». Në Universitetin e Tetovës kandidatja Aurora Karameti ka ligjëruar edhe në studimet Master, prej vitit 2014, në të gjitha Programet e Drejtësisë, në Programin e Gazetarisë dhe Medias dhe në Programin e Kriminalistikës ku ka mbajtur lëndët : « Metodologjia e hulumtimit shkencor », « Gazetaria televizive », « Gazetaria e profilizuar », « Metododat e hulumtimit gazetaresk dhe mediatik », « Produksioni digjital në mediat televizive dhe online », « Etika në administratën publike », “Media globale”, “Mbledhja e të dhënave dhe burimi i informacionit”, “Burimi i informacionit dhe verifikimi i fakteve”, “Etika dhe deontologjia e policisë”.

Që prej vitit akademik 2014-2015 kandidatja ka qenë e angazhuar si mësimdhënëse part-time në Shkollën e Gazetarisë së Parisit, Programi i Mësimdhënies në Distançë (*Ecole Supérieure de Journalisme de Paris, EAD-Programme d'enseignement à distance*) ku ka ligjëruar deri në vitin akademik 2018-2019.

Gjatë karrierës akademike Prof. Inord. Dr. Aurora Karameti është avancuar profesionalisht me disa programe të financuara nga institucione të vendit dhe të huaja. Në vitin 2004 (11-25 Shtator) ka qëndruar në *Indiana University-Perdue University*, Indianapolis, SHBA, në një program shkëmbimi eksperience.

Në vitin 2006 (janar-maj) ka ndjekur programin JFDP, të financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit për kërkime dhe shkëmbim eksperience në *Florida State University*, SHBA.

Në vitet 2005-2007 ka ndjekur programin dy-vjeçar të trajnimit për teknologji, gjuhë angleze dhe metodologji mësimdhënieje nga *Indiana University*, SHBA dhe *Universiteti i EJL*, Tetovë.

Në vitin 2018 ka qëndruar në *Journalism School, University of Missouri* dhe *Alfred Presly Press Partners Institute* në SHBA për tri javë në kuadër të një programi akademik-profesional ku ka qenë e autorizuar të kontaktojë me Dekanatin dhe ekipin e J-School për shkëmbim përvoja mbi zhvillimin e kurikulave, metodologjinë e mësimdhënies, teknologjitë e reja, praktikat e shkëmbimeve ndërkombëtare etj. Ka ndjekur gjithashtu trajnime të shumta disa-ditore me prezencë fizike dhe online me fokus zhvillimin profesional.

Me Vendim të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tetovës Nr. 04-2490/1 të datës 23.05.2018 kandidatja mori thirrjen **Profesor Inordinar (Asociuar)** për lëndët : 1. « Teoritë e modernizmit dhe media globale » dhe 2. « Redaktimi në media » në Programin Studimor të Gazetarisë dhe lëndën « Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun » në Programin Studimor të Kriminalistikës në Universitetin e Tetovës.

3. PËRVOJA PROFESIONALE :

- Kandidatja Prof. Inord. Dr. Aurora Ndrio Karameti e ka nisur karrierën profesionale si gazetare me kohë të pjesshme në Radio Tirana dhe në Departamentin e Lajmeve të Jashtme të Televizionit Publik Shqiptar në Tiranë.
- Më pas ka punuar si gazetare dhe moderatore e emisioneve informative në disa prej televizioneve më të rëndësishme private në vitet 2000-2003 në Tiranë si TV Koha (Koha Jonë), TV Arbëria dhe TV Alsat.
- Kandidatja është njohëse e institucioneve Europiane. Në vitin 2000 (03 Prill-30 Qershor) ka kryer stazh në Departamentin e Marrëdhënieve Publike të Këshillit të Europës në Strasburg, Francë. Në kuadër të përvojës, ka realizuar me sukses krijimin e broshurës “Këshilli i Europës”, në gjuhën shqipe.
- Në vitin 2004, ka qenë ndër të parët mësimdhënës që ka fituar financim për projektin Mësim përmes Shërbimit në Komunitet « Service Learning project : High schools and the local community for protecting the environment », nga Universiteti i Indianës në SHBA.
- Gjithashtu nga Universiteti i Indianës, është përzgjedhur për një Projekt Pilot, si bashkë-trajnesja e parë e Qendrës së Karrierës së UEJL, në vitin 2004, ku ka mbajtur ligjërata mbi Zhvillimin e Karrierës, një kurs i dizajnuar nga profesori i IUPUI, David Randall.
- Ka drejtuar botimin e gazetës së studentëve të Shkencave të Komunikimit në UEJL, CAMPUS, nga viti 2004 deri në vitin 2011.

- Në kuadër të projektit *Tempus* mbi zbatimin e sistemit ECTS (European Credit Transfer System), kandidatja ka qenë përfaqësuese e UEJL në aktivitetet e zhvilluara me universitetet partnere si Politecnico di Torino, Shën Kirili dhe Metodi Shkup dhe Universiteti i Manastirit, përgjatë vitit 2005.
- Në vitin 2012 ka qenë e angazhuar nga kompania ND Ballkan në Tetovë, në një projekt për studim të tregut të medias në Maqedoni dhe propozim për avancimin e medias në gjuhën shqipe, në vitin 2012.
- Në vitin 2013 është angazhuar si analiste nga MEDIAMORPHOSIS për shkrimin e artikujve kritike mbi produksionin e medias në Maqedoni në kuadër të programit « Strengthening Media in Macedonia - Media Fact-Checking Service Component » financuar nga USAID.
- Në mars-prill 2018 ka ndjekur një trajnim intensiv mbi multimedien për një grup gazetarësh nga Maqedonia në Shkollën e Gazetarisë së Universitetit të Missouriit në SHBA, në kuadër të programit *Alfred Friendly Macedonia Media Fellowship*.

4. PJESËMARRJA NË AKTIVITETET SHKENCORE (2018-2022):

Prej marrjes së thirrjes *Profesor Inordinar*, kandidatja ka vazhdimësi relevante në aktivitetin kërkimor-shkencor. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore dhe aktivitete ndërkombëtare dhe rajonale, me prezantime të punimeve origjinale, me prani fizike dhe online, të paraqitura në vijim:

Konferencë shkencore rajonale *Prirje dhe sfida të mediave televizive shqiptare në epokën e post-digjitalizimit*. Prezantim i studimit me titull “Ndikimi i digjitalizimit në programacionin e televizioneve shqiptare në Maqedoninë e Veriut”. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës, 14.12.2022.

Konferencë shkencore ndërkombëtare *War, conflict and society*. Prezantim i studimit me titull “The news media facing the question of patriotism in armed conflicts”. Kolegji Universitar AAB, Prishtinë, 09-10.12.2022.

Konferencë shkencore ndërkombëtare *The Western Balkans between the Russian influence and the European perspective*. Prezantim i studimit me titull “The impact of effective police-community communication at the prevention of criminality”, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, 16-18.12.2022.

Konferencë shkencore ndërkombëtare *Government Performance in the times of Covid 19 Pandemic: Human Rights and Educational challenges*. Prezantim i studimit me titull “*The safety of journalists during the pandemic state of emergency Covid19*”. Universiteti Haxhi Zeka, Pejë, 12.11.2021.

Konferencë në përfundim të projektit «ALB2EU – European Values for Albanian Integration», pjesëmarrje si paneliste. Values University & LIDH. Projekt i Erasmus+ Programme dhe Jean Monnet Activities. Lisbonë, 22.02.2021.

Aktiviteti kërkimor-shkencor i kandidates Prof. Inord. Dr. Aurora Karameti konfirmohet edhe me punimet shkencore të botuara në **gjashtë revista shkencore me faktor impakti**, revista

ndërkombëtare dhe me **bord ndërkombëtar** si edhe botime kolektive shkencore ndërkombëtare. Të gjitha publikimet me karakter kërkimor-shkencor prezantohen në vazhdim të këtij referati:

5. LISTË E PUNIMEVE SHKENCORE DHE BOTIMEVE PROFESIONALE TË PUBLIKUARA (2018-2023) :

- **LIBËR** : *Informacioni dhe komunikimi në kohë krize*. Botues : Insituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare. Shkup, 2022. ISBN: 978-608-4801-15-3
 - **LIBËR** kolektiv: *Médiations et migrations*. Autore e kaptinës: “Le traitement et socio-politico-médiatique de la migration transitoire en Macédoine”. Botues: L’Harmattan. Paris, 2019. ISBN: 978-2-343-18368-8
1. **Artikull**: “National news media facing the challenge of patriotism in war time”. *Vizione*. No. 40. 2023, faqe 245-254.
 2. **Artikull**: “Content analysis method in media studies”. *Vizione*. No. 40. 2023, faqe 21-36.
 3. **Artikull**: “Ndikimi i digjitalizimit në programacionin e televizioneve në Maqedoninë e Veriut”. Revistë ndërkombëtare. Botim i Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës.
 4. **Artikull**: “Agenda-setting, a political communication theory applied in media studies, updated”. *Centrum*. No.18/ 2022. Faqe 24-38.
 5. **Artikull**: “Save the journalist: news media in time of crises”. *Vizione*. Nr. 38/2022, faqe 291-305.
 6. **Artikull**: “News media and political agenda during the Covid19 pandemic”. *Justicia - International Journal of Legal Sciences*, Vol. 8 | No13-14, 2020, faqe 23-28.
 7. **Artikull**: “Extradition-its nature and scope in criminal matters”. *Justicia - International Journal of Legal Sciences* Vol. 7 | No. 11, 2019, faqe 33-43.

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Komisioni recensues pasi vlerësoi pozitivisht kualifikimin e kandidatës Profesor Inordinar Doktor Aurora Karameti (Ndrio) në të gjitha ciklet e studimeve si dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe akademik në universitete perëndimore me renome në sferën e Komunikimit dhe Mas-medimeve, pasi vlerësoi vazhdimësinë e aktivitetit kërkimor-shkencor shprehur në pjesëmarrje të vazhdueshme në aktivitete shkencore dhe në publikime në revista shkencore ndërkombëtare dhe me faktor impakti, pasi vlerësoi kontributin profesional në mësimdhënie në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në Universitetin e Tetovës por edhe në institucione me renome botërore siç është Shkolla e Gazetarisë së Parisit dhe universitete

relevante të rajonit dhe vlerësoi pozitivisht përputhshmërinë e kualifikimit të kandidates me lëndët mësimore që konkurron në këtë konkurs,

KONSTATON DHE PROPOZON

se kandidatja Profesor Inordinar Doktor Aurora Ndrio Karameti i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Ordinar** (*Full Professor*) sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin për Arsim të Lartë në RMV, Statutin e Universitetit të Tetovës dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës.

Komisioni recensues ka nderin t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që **Prof. Dr. Aurora Karameti (Ndrio)** të zgjidhet **Profesor Ordinar** (*Full Professor*) në sferën Komunikime dhe Mas-Medime (50706 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

KOMISIONI RECENSUES:

1. Prof. Dr. Briseida MEMA, Kryetare

2. Prof. Dr. Makdolna Dona KOLAR-PANOV, Anëtare

3. Prof. Dr. Ferat POLISI, Anëtar

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TUTULL MËSIMOR-SHKENCOR – PROFESOR ORDINAR/ TITULL SHKENCOR

Kandidati: Prof. Dr. Aurora Karameti

Institucioni: Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës

Fusha shkencore: Komunikime dhe Mas-Medime (50706 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë Suksesi mesatar në ciklin e parë: 9.14 Suksesi mesatar në ciklin e dytë: 10.00	PO
2	Titull shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet: Doktor i shkencave të informacionit dhe komunikimit Emri i sferës shkencore: Shkenca humane dhe sociale Fushës: 50706 - Komunikime dhe Mas-medime, Degës: Informacion	PO
3	Të ketë të publikuara së paku 6 (gjashtë) punime shkencore të recensuara* në publikime shkencore referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje I. 1. Emri i revistës shkencore: VIZIONE 2. Emri i bazës elektronike të revistave: EBSCO 3. Titulli i punimit: <i>Content analysis method in media studies</i> 4. Data e publikimit: Janar 2023 II. 1. Emri i revistës shkencore: VIZIONE 2. Emri i bazës elektronike të revistave: EBSCO 3. Titulli i punimit: <i>National news media facing the challenge of patriotism in war time</i> 4. Data e publikimit: Janar 2023 III.	PO

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	<p>1. Emri i revistës shkencore: CENTRUM 2. Emri i bazës elektronike të revistave: Index Copernicus, Scope Database 3. Titulli i punimit: <i>Agenda-setting, a political communication theory applied in media studies, updated</i> 4. Data e publikimit: Dhjetor 2022</p> <p>IV. 1. Emri i revistës shkencore: VIZIONE 2. Emri i bazës elektronike të revistave: EBSCO 3. Titulli i punimit: <i>Save the journalist: news media in time of crisis</i> 4. Data e publikimit: Shkurt 2022</p> <p>V. 1. Emri i revistës shkencore: JUSTICIA 2. Emri i bazës elektronike të revistave: EBSCO 3. Titulli i punimit: <i>News media and political agenda during the Covid19 pandemic</i> 4. Data e publikimit: 2020</p> <p>VI. 1. Emri i revistës shkencore: JUSTICIA 2. Emri i bazës elektronike të revistave: EBSCO 3. Titulli i punimit: <i>Extradition- it`s nature and scope in criminal matters</i> 4. Data e publikimit: 2019</p>	
3.1	<p>Libri ose pjesa e librit të recensuar dhe publikuar në shtetin anëtar i Bashkimit Evropian/ose OBZHE 1. Titulli i librit: <i>Komunikimi në kohë krize. Rasti i Maqedonisë 2001</i> 2. Emri i shtetit anëtar i BE/ose OBZHE: RMV 3. Botuesi, viti dhe vendi i botimit/publikimit: Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare, 2022, Shkup.</p>	PO
5	<p>Zgjedhja e mëparshme në titullin mësimor-shkencor: Profesor i asociuar, data dhe numri i Buletinit: 23.05.2018 Nr. 04-2490/1</p>	PO
6	<p>Posedon aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë 1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë Universiteti i Tetovës dhe Universiteti i Europës Juglindore</p>	PO

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	2. Lloji i trajnimit/ përvoja/ arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë: Asistent, Docent, Profesor Inordinar (i Asociuar) 3. Periudha e fitimit të aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë: 2004 – 2012 - 2018.	
7	Njohja e të paktën një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të universitetit, d.m.th. një shkollë e lartë Profesionale e pavarur. Gjuha e huaj: Anglisht Emri i dokumentit: CERTIFIKATË	PO

*Për kandidatin/ët që ka publikuar më tepër se 6 (gjashtë) punime shkencore në publikime shkencore referente, komisioni recensues do t'i theksojë, vlerësojë me pikë dhe vendos në Formularin 2.

**Kushti i theksuar do të zbatohet pas kalimit të tri viteve nga hyrja në fuqi e Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore, nr. 82/2018).

FORMULARI 2

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Prof. Inord. Dr. Aurora Karameti (Ndrio)**
 Institucioni: **Universiteti i Tetovës, Fakulteti Juridik**
 Programi studimor: **Studime të Gazetarisë,**
 Programi studimor : **Studime të Kriminalistikës**
 Fusha shkencore: **Komunikime dhe Mas-Media**

VEPRIMTARIA EDUKATIVO - MËSIMORE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Mbajtja e Ligjëratave në ciklin e parë të studimeve	
1.2	Teoritë e modernizmit dhe media globale (2+1, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.3	Redaktimi në media (2+2, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.4	Psikologjia e komunikimit (2+2, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.5	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor (2+1, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.6	Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (2+0, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
2	Mbajtja e Ligjëratave në ciklin e dytë të studimeve	

2.1	Metodologjia e hulumtimit gazetaresk dhe mediatik (2+1, 1 semestër)	2x15x1x0.05=1.5
2.2	Media globale (2+1, 1 semestër)	2x15x1x0.05=1.5
2.3	Produksioni digjital në mediat televizive dhe online (2+1, 1 semestër)	2x15x1x0.05=1.5
2.4	Mbledhja e të dhënave dhe burimi i informacionit, (2+1, 1 semestër)	2x15x1x0.05=1.5
2.5	Etika dhe deontologjia e policisë (2+0, 2 semestra)	2x15x2x0.05=3
2.6	Burimi i informacionit dhe verifikimi i fakteve (2+1, 1 semestër)	2x15x1x0.05=1.5
3	Mbajtja e ushtrimeve në ciklin e parë të studimeve	
3.1	Teoritë e modernizmit dhe media globale (2+1, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25
3.2	Redaktimi në media (2+2, 5 semestra)	2x15x5x0.03=4.5
3.3	Psikologjia e komunikimit (2+2, 5 semestra)	2x15x5x0.03=4.5
3.4	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor (2+1, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25
4	Përgatitje e lëndës së re	
4.1	Metodologjia e hulumtimit gazetaresk dhe mediatik	1+1.5=2.5
4.2	Media globale	1+1.5=2.5
4.3	Produksioni digjital në TV dhe online	1+1.5=2.5
4.4	Mbledhja e të dhënave dhe burimi i informacionit,	1+1.5=2.5
4.5	Etika dhe deontologjia e policisë	1+1.5=2.5
4.6	Burimi i informacionit dhe verifikimi i fakteve	1+1.5=2.5
5	Mbajtja e Konsultimeve	
5.1	Teoritë e modernizmit dhe media globale (2+1, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.2	Redaktimi në media (2+2, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.3	Psikologjia e komunikimit (2+2, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.4	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor (2+1, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.5	Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (2+0, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
6	Profesor Vizitor në programin e mësimdhënies në distancë (Online) në <i>Ecole Supérieure de Journalisme</i> , Paris, Francë dhe Kamerun, për 1 semestër (dimëror, 2018-2019)	1x6=6
7	Profesor Vizitor në Fakultetin e Komunikimit Masiv të Kolegjit Universitar AAB, për 1 semestër (dimëror 2018-2019)	1x2=2
9	Mentorim i punimeve të Diplomës	3x0.2=0.6
10	Mentorim i Punimeve të Masterit	1x2=2
11	Anëtar dhe Kryetar në Komisione për Mbrojtjen e Punimeve të Masterit	2x0.5=1
	Gjithsej:	81.35

VEPRIMTARIA KËRKIMORE - SHKENCORE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Pjesmarrje në konferenca shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare	
1.2	Konferencë shkencore rajonale <i>Prirje dhe sfida të mediave televizive shqiptare në epokën e post-digjitalizimit. Prezantim i hulumtimit me titull “Ndikimi i digjitalizimit në programacionin e televizioneve shqiptare në Maqedoninë e Veriut”.</i>	1

	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës, 14.12.2022.	
1.3	Konferencë shkencore ndërkombëtare <i>War, conflict and society</i> . <u>Prezantim i studimit me titull</u> “The news media facing the question of patriotism in armed conflicts”. Kolegji Universitar AAB, Prishtinë, 09-10.12.2022.	1
1.4	Konferencë shkencore ndërkombëtare <i>The Western Balkans between the Russian influence and the European perspective</i> . <u>Prezantim i studimit me titull</u> “The impact of effective police-community communication at the prevention of criminality”, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, 16-18.11.2022.	1
1.5	Konferencë shkencore ndërkombëtare <i>Government Performance in the times of Covid 19 Pandemic: Human Rights and Educational challenges</i> . <u>Prezantim i hulumtimit me titull</u> “The safety of journalists during the pandemic state of emergency Covid19”. Universiteti Haxhi Zeka, Pejë, 12.11.2021.	1
1.6	Konferencë ndërkombëtare në përfundim të projektit « <i>ALB2EU – European Values for Albanian Integration</i> ». Values University & LIDH. Paneliste. Projekt i Erasmur+ Programme dhe Jean Monnet Activities. 22.02.2021. Portugali.	1
2	Artikuj me Rezultate Shkencore Origjinale, të Publikuara në Revistë Referente Shkencore / Profesionale me Bord Redaktues Ndërkombëtar	
2.1	Artikull: Aurora Karameti. “Content analysis method in media studies”. <i>Vizione</i> . No. 40. 2023, faqe 21-36.	6
2.2	Artikull: Aurora Karameti dhe Ymer Ismaili “National news media facing the challenge of patriotism in war time”. <i>Vizione</i> . No. 40. 2023, faqe 245-254.	5.4
2.3	Artikull: Aurora Karameti “Ndikimi i digjitalizimit në programacionin e televizioneve në Maqedoninë e Veriut”. Botim i Universitetit të Tiranës.	6
2.4	Artikull: Aurora Karameti “Agenda-setting, teori e komunikimit politik e zbatuar në studimet mbi median, e përditësuar”. <i>Centrum</i> . No.18/2022. Faqe 24-38.	6
2.5	Artikull: Artan Grubi dhe Aurora Karameti “Save the journalist: news media in time of crises”. <i>Vizione</i> . No. 38/2022, faqe 291-305.	5.4
2.6	Artikull: Aurora Karameti dhe Arta Bilalli “News media and political agenda during the Covid19 pandemic”. <i>Justicia - International Journal of Legal Sciences</i> , Vol. 8 No13-14, 2020, faqe 23-28.	5.4
2.7	Artikull: Arta Bilalli-Zendeli dhe Aurora Karameti “Extradition-its nature and scope in criminal matters”. <i>Justicia - International Journal of Legal Sciences</i> Vol. 7 No. 11, 2019, faqe 33-43.	5.4
	Gjithsej:	44.6

VEPRIMTARIA PROFESIONALE - ZBATUESE

Nr. Rendor	Emri i Aktivitetit	Pikët
1	Libra të botuar dhe recensione	
1.1	Libër universitar : Aurora Karameti. <i>Komunikimi në kohë krize – Rasti i Maqedonisë 2001.</i> Botues : Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare, Shkup, 2022. ISBN: 978-608-4801-15-3	10
1.2	Pjesë e librit të recensuar dhe publikuar në një shtet anëtar të Unionit Evropian/ose OBZHE : <i>Mediations et migrations</i> (Pjesë e koleksionit të veprave « Communication et Civilisation », nën drejtimin e A. Nader & J. Boulos, faqe 39-51). Recensues Prof. Anne-Marie Laulan. Aurora Karameti, autore e kaptinës: “ <i>Le traitement et socio-politico-médiatique de la migration transitoire en Macédoine</i> ” Botues : L’Harmattan, Paris. 2019. ISBN : 978-2-343-18368-8	8
1.3	Recension i librit: <i>Terminologjia politike bashkëkohore.</i> me autor Ymer Ismaili. Botues: ISPN, Shkup, 2023. ISBN: 978-608-4801-16-0	1
2	Pjesëmarrje në projekte shkencore, dhe aktivitete profesionale	
2.1	Pjesëmarrje në trajnimin “Transforming Higher Education with a focus on Social entrepreneurship & Diversity and inclusion”, financuar nga Erasmus+ Programme and European Union. Universiteti i Tetovës, 30-31 mars 2022. Çertifikatë.	1
2.2	Pjesëmarrje në seminarin online “Challenges and Rewards of Starting An Online News Platform” organizuar nga <i>Alfred Friendly Press Partners Institute</i> ne bashkepunim me <i>University of Missouri School of Journalism</i> . 2022. Artikull i botuar.	1
2.3	Dy seminare online “2019 European Distance Learning Week” organizuar nga <i>European Distance and E-Learning Network (EDEN)</i> 11 dhe 15 nëntor 2019. Certifikatë niveli/medalje bronx.	1
	GJITHSEJ:	22

VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Veprimtari me interes më të gjerë	
1.1	Anëtare e Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, nga dhjetori i vitit 2012.	1

1.2	Pregatitje e elaboreteve të programit studimor të ciklit të dytë – Master në Studime të Gazetarisë në Fakultetin Juridik – UT, 2021.	1
1.3	-Anëtare e Komisionit Recensues për zgjedhjen në thirrjen <i>Docent</i> të mësimdhënës Dr. Arta Xhelili nga fusha e Komunikimit në Fakultetin e Gazetarisë, Universiteti Nëna Terezë. Vendim dt. 27.05.2021, shpallur në Buletinin Nr.34 dt. 21.06.2021, faqe 119.	1
	-Anëtare e Komisionit Recensues për zgjedhjen <i>Profesor i asociuar</i> të mësimdhënësit Doc. Dr. Resul Sinani nga fusha e Komunikimit dhe Gazetarisë në Kolegjin AAB Prishtinë. Shpallur ne Buletinin Nr. 7 dt. 15.07.2020 faqe 239.	1
	-Anëtare e Komisionit Recensues për zgjedhjen <i>Profesor i asociuar</i> të mësimdhënësit Doc. Dr. Gazmend Abrashi nga fusha e Komunikimit dhe Gazetarisë në Kolegjin AAB Prishtinë. Shpallur ne Buletinin Nr. 7 dt. 15.07.2020 faqe 245.	1
1.4	Referuese për botimin shkencor rezultat i projektit hulumtues “Gjuha e urrejtjes gjatë kampanjës zgjedhore parlamentare 2020 në Republikën e Maqedonisë së Veriut: efektet në sjelljen e qytetarëve në relacionet intergrupore”, udhëhequr nga Qendra për Paqe dhe Komunikim Transkulturore, mbajtur në Universitetin e Tetovës. 2021.	1
1.5	Referuese në promovimin e librit shkencor “Fjalori politik i Berishës ‘90 – ‘92” i autorit Alfred Lela në Universitetin e Tetovës. Tetor 2018.	1
1.6	Anëtare e bordit drejtues të OJF <i>Instituti i promovimit të vlerave sociale dhe urbane</i> , prej 01.03.2021, Tiranë.	1
1.7	Anëtare e shoqatës së ish-studentëve (<i>alumni</i>) të mbështetur nga SHBA në Republikën e Maqedonisë së Veriut (MAAA)	1
	GJITHSEJ :	9

Nr.	Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhjen në thirrje	Pikët
1.	Veprimtaria mësimore-shkencore	81.35
2.	Veprimtaria shkencore-hulumtuese	44.6
3.	Veprimtaria profesionale-aplikative	22
4.	Veprimtaria me interes më të gjerë	9
	Gjithsej	156.95

Komisioni Recensues:

Prof. Dr. Briseida MEMA, Kryetare _____

Prof. Dr. Makdolna Dona KOLAR - PANOV, Anëtare _____

Prof. Dr. Ferat POLISI, anëtar _____

RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES

Për zgjedhjen - rizgjedhjen e mësimdhënësit në të gjitha thirrjet mësimore - shkencore në lëmin E drejta administrative (50802 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Në lidhje me Konkursin e shpallur më datë 19.04.2023 në gazetën “Koha”, “Слободен печат” dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës (www.unite.edu.mk/konkurse) për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore **në lëmin E drejta administrative (50802 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik nr. 13-290/1 të datës 09.05.2023, formohet Komisioni recensues në përbërje:

- 1. Prof. dr. Mersim Maksuti (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës;**
- 2. Prof. dr. Jusuf Zejneli (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës;**
- 3. Prof. dr. Drita Mamuti Fazlia (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.**

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenin 172, 173, 175 dhe 176 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 82/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 178/2021), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Senatit të Universitetit të Tetovës këtë:

R E C E N S I O N

Në konkursin e datës 19.04.2023, të shpallur në gazetata përkatëse: “Koha“, “Слободен Печат“ dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës: “www.unite.edu.mk“, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore **në lëmin E drejta administrative (50802 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**, në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, ka konkurruar kandidatët: **Dr. sc. Muhammed Izeti dhe Dr. sc. Lindita Neziri**

1. Dr. sc. Muhammed Izeti, i lindur më 17.02.1996 në Tetovë, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me numër aplikimi 040113 të datës 19.04.2023. Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me konkursin, titullit të lartpërmendur ia paraqet këtë përshkrim:

1. 1. Të dhënat biografike për kandidatin

Muhammed Izeti u lind më 17 shkurt 1996 në Tetovë. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Tetovë. Në vitin 2014 u regjistrua në Fakultetin Juridik në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, ku u diplomua në vitin 2017. Në të njëjtin vit, ai u regjistrua në Fakultetin Juridik në magistraturë dhe në vitin 2019 mori titullin master duke e mbrojtur temën e disertacionit *ADMINISTRIMI DHE DENACIONALIZIMI I VAKËFIT TË BASHKËSISË FETARE ISLAME NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT ME VËSHTRIM TË POSAÇËM NË RAJONIN E TETOVËS*. Në vitin 2020 e regjistroi magistraturën e dytë në Fakultetin Juridik në drejtimin administrativ/kushtetues dhe në vitin 2022 magjistroi me temën e disertacionit *STATUSI KUSHTETUES I BASHKËSISË FETARE ISLAME NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT DHE E DREJTA AUTONOME E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SAJ*. Në vitin 2019-2020 u regjistrua në studimet e doktoraturës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Novi Pazarit. Pas përfundimit të provimeve, temën e doktoraturës me titull “MARRËDHËNIET SHTET-VAKËF NË HAPSIRAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË VERIUT DHE DENACIONALIZIMI I PRONËS SË VAKËFIT” e mori nën mentorimin e Prof. dr. Jeton Shasivarit, të cilën e mbrojti me 3 qershor të vitit 2022.

1. 2. Të dhëna për veprimtarinë mësimore – shkencore

Dr. Muhammed Izeti tri vite punoi si praktikant në zyrën noteriale të Noterit Arif Neziri në Tetovë, pas së cilës hapi kompaninë e tij, të cilën vazhdon ta administrojë. Në vitin akademik 2021-2022 ishte demonstrues në lëndën *E Drejta Kushtetuese* në Fakultetin Juridik të Evropës Juglindore në Tetovë. Në vitin akademik 2022-2023 ishte ligjerues part-time në lëndët : *Gjyqësia Kushtetuese, E Drejta Kushtetuese dhe E Drejta Kushtetuese Krahasuese* në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës.

1.3. Kandidati Dr. sc. Muhammed Izeti është autor i librit:

- IZETI, Muhammed, *Macedonian Legislattion in front of European Challenges*, Lambert Academic Publishing, 2020

1.4. Kandidati Dr. sc. Muhammed Izeti ka publikuar këto punime shkencore

- Muhammed Izeti, Prof.dr. Suad Becirovic, *MONETARY WAQF IN THE OTTOMAN STATE AND THEIR FUNCTIONS IN THE TERRITORY OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA*, në revistën: Economic Vision, International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism 13-14 / 2020, Tetovë;
- Muhammed Izeti, *PROOFING AND EVIDENCE IN LITIGATION PROCEDURES IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA WITH SPECIAL OVERVIEW ON PROPERTY-LEGAL RELATIONS*, në revistën: International Journal of Academic Research and Reflection (IJARR) Volume 8, Number 2, 2020;
- Muhammed Izeti, *CRIMINAL LAW MEASURES OF PROTECTION IN CASES OF DOMESTIC VIOLENCE AND LEGAL REGULATIONS IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA*, European Journal of Research and Reflection in Arts and Humanities (EJRAH) Volume 8, Number 1, 2020;

- Muhammed Izeti, *RELATIONS BETWEEN WUQOOF AND THE STATE DURING THE OTTOMAN EMPIRE*, në revistën: Justicia, International Journal of Legal Sciences, 13-14 / 2020, Tetovë;
- Muhammed Izeti, *ADJUSTMENT OF REGULATIONS IN THE REPUBLIC OF NORTHERN MACEDONIA WITH EU REGULATIONS WITH SPECIAL REVIEW ON IMMIGRATION AND ASYLUM RIGHTS*, në revistën: European Journal of Research in Social Sciences (EJRSS) Volume 8, Number 2, 2020;
- Muhammed Izeti, Prof.dr.Muamer Nicević, *INTERNATIONAL JURIDICAL PRINCIPLES FOR PREVENTION OF JUVENILE DELINQUENCY AND LEGAL LEGISLATION AND PRACTICE IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA*, në revistën: International Journal of Social and Human Sciences (PHILOSOPHICA), Vol.7, No. 13-14, 2020, Tetovë;
- Muhammed Izeti, *DRUŠTVENO PRAVNI POLOŽAJ VAKUFA U PROSTORU REPUBLIKE SJEVERNA MAKEDONIJA OD OSNIVANJA DO DANAS*, në revistën: Univerzitetska misao - časopis za nauku, kulturu i umjetnost, Vëllimi. 19, fq. 137-146, 2020, Novi Pazar;
- Muhammed Izeti, *RAZVOD BRAKA U ŠERIJATSKOM PRAVU*, në revistën: Islamska Misao, nr. 12, 2021, Novi Pazar.
- Muhammed Izeti, *FREEDOM OF BELIEF AND THE RELATION BETWEEN CONSTITUTION AND THE ISLAMIC RELIGIOUS COMMUNITY IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA*, në revistën : Freedom, nr. 5/6, Vëllimi : 3, 2022 Tetovë.

1.5. Kandidati Dr. sc. Muhammed Izeti ka marrë pjesë në këto konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare:

- IZETI, Muhammed, *Aspektet ligjore dhe institucionale ndërkombëtare për pengimin e trafikimit të femrës*, Macedonian Medical Students Association, 09.03.2021 në Tetovë.
- IZETI, Muhammed, *Freedom of Belief and the Relation Between Constitution and the Islamic Religious Community in the Republic of North Macedonia*, International Congress of the Faculty of Law, Nëntor 2022, Tetovë.
- IZETI, Muhammed, *Uluslararası Seyyid Ali Sultan Sempozyumu ve Anma Etkinliği*, 19-20 nëntor 2022, Komotini, Greqi.

1.6. Të dhëna për veprimtarinë me interes më të gjerë

- Sekretar i shoqatës “Klubi i vëzhguesve Kallkan”, Tetovë;
- Nënkyetar i bordit të shoqatës “Kalkan - Eđitim, Kùltùr ve Sanat Derneđi” me seli në Tetovë;
- Themelues dhe drejtues i firmës EUTECH N.T.P.Nj., Tetovë;

Kandidati Muhammed Izeti, me numër aplikimi 040113 të datës 19.04.2023 ka dorëzuar këto dokumente: Diplomë të noterizuar për kryerjen e ciklit të parë, Fakultetit Juridik në UEJL; Diplomë të noterizuar për kryerjen e studimeve të ciklit të dytë, magistraturës, në Fakultetin Juridik në UEJL; Diplomë të noterizuar dhe Vendim për nostrifikim të diplomës për kryerjen e ciklit të tretë, doktoratës, në Universitetin ndërkombëtar të Novi Pazarit; Vërtetim për njohjen të gjuhës angleze, punim të doktoraturës, certifikatë të lindjes, certifikatë të shtetësisë, listën dhe kopje të punimeve, biografi të shkurtë nga e cila mund të konstatohet aktivitet permanent në organizime shkencore, seminare dhe konferenca të shumta të nivelit shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtar.

2. Dr. sc. Lindita Neziri, Të dhënat biografike për kandidaten

Dr. sc. Lindita Neziri u lind më 30.gusht.1985 në Tetovë. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Tetovë. Në vitin 2004 u regjistrua në Fakultetin Juridik në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, ku u diplomua në vitin 2008. Në të njëjtin vit, ajo u regjistrua në Fakultetin Juridik në magistraturë dhe në vitin 2017 mori titullin master duke e mbrojtur temën e disertacionit *OPENING OF THE INHERITANCE IN THE DISTRICT OF THE BASIC COURT OF TETOVO FOR THE PERIOD 2007-2012*. Në vitin 2018 u regjistrua në studimet e doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Shoqërore bashkëkohore të Universitetit të Evropës Juglindore. Pas përfundimit të provimeve, temën e doktoraturës me titull “WOMEN’S RIGHT TO INHERIT PROPERTY. COMPARATIVE ASPECTS OF THE WESTERN BALKANS WITH SPECIAL EMPHASIS ON THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA”, të cilën e mbrojti në qershor të vitit 2021.

2.1 Kandidatja Dr. sc. Lindita Neziri ka publikuar këto punime shkencore

- *RULE OF LAW IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA OVER THE LAST DECADE EVALUATED BY INTERNATIONAL AUTHORITIES*, në revistën: Balkan Social Science Review, 20 / 2022 ;
- *REVIEW OF THE INHERITANCE MEASURE IN THE NOTARY. DIFFERENCES BETWEEN THEORY AND ITS PRACTICE IN PRACTICE: THE CASE OF NORTHERN MACEDONIA*, në revistën: Knowledge International Journal Scientific Papers, Volume 52.1, Skopje, 2022, fq.167-171;
- *ANALYSIS OF THE ELECTORAL SYSTEM FOR PRESIDENTIAL ELECTIONS IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA: ADVANTAGES AND DISADVANTAGES*, Knowledge International Journal Scientific Papers Volume 51,Skopje, 2020, f. 251-256;
- *COMMON TRADITIONAL NORMS AGAINST LEGAL NORMS ON THE FAMILY PROPERTY INHERITANCE DISTRIBUTION BETWEEN GENDERS AMONG THE ALBANIANS OF NORTHERN MACEDONIA*, në revistën: Knowledge International Journal Scientific Papers,Volume 40.6 , Skopje, f. 1049-1054;
- *THE SOCIAL AND CARE SYSTEM AND FINANCIAL IMPLICATIONS FOR THE CHILDREN WITHOUT PARENTAL CARE IN NORTH MACEDONIA*, në revistën: International Institute of Social and Economic Sciences, Volume 9, 2019, Prague;
- *ANALYSIS OF PROPERTY INHERITANCE NORMS, INSTITUTIONS AND PROCEDURES IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA*, në revistën: Knowledge International Journal Scientific Papers, Vol.35.5, 2019, Bansko;
- *BETWEEN LAW AND TRADITIONS – THE PRACTICE OF (NON) PARTICIPATION OF GIRLS FROM THE ALBANIAN COMMUNITY IN MACEDONIA IN THE FAMILY PROPERTY INHERITANCE*, në revistën: European Journal of Interdisciplinary studies, fq. 57-66, 2018, Rottenburg, Germany;
- *EU TRENDS ON PENSION DEVELOPMENTS AND CHALLENGES FOR MACEDONIAN PENSION SYSTEM*, në revistën: Acta Universitatis Danubis, Administration Journal,Vëllimi 9, nr. 2, 2017,fq. 16-24.

2. 2. Kandidatja Dr. sc. Lindita Neziri ka marrë pjesë në këto konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare:

